



INSTITUCIONET E PËRKOHSHME VETËQEVERISËSE
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA

QEVERIA E KOSOVËS – GOVERNMENT OF KOSOVO – VLADA KOSOVA

**MINISTRIA E ARSIMIT
SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË**

**MINISTRY OF EDUCATION
SCIENCE & TECHNOLOGY**

**MINISTARSTVO ZA OBRAZOVANJE
NAUKU I TEHNOLOGIJU**

Zyra e Sekretarit të Përhershëm

Office of Permanent Secretary

Kancelarija Stalnog Sekretara

NUMËR: 15/2003 MASHT

DATË: 22-08-2003

Lënda: Barasvlera dhe nostrifikimi i diplomave të fituara në Institucionet e Arsimit të lartë të Kosovës, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) në tekstin e mëtejme nxjerr këtë:

UDHËZIM ADMINISTRATIV

Neni 1 Qëllimi

1.1 Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ është përcaktimi i barasvlerës dhe nostrifikimi i certifikatave dhe diplomave të fituara në institucionet e Arsimit të lartë (IAL) jashtë Kosovës.

Neni 2 Barasvlera dhe nostrifikimi

2.1 Barasvlera dhe nostrifikimi i dëftësave, diplomave dhe dokumenteve tjera të qytetarëve kosovarë të fituara në Institucionet e arsimit të lartë jashtë Kosovës, bëhet që të pranohen njësoj me diplomën, certifikatën dhe dokumentet tjera të fakultetit përkatës të fituara në institucionin përkatës të Kosovës .

2.2. Qytetarët kosovar, kanë të drejtë të kërkojnë që të bëhet barasvlera dhe nostrifikimi i diplomave, certifikatave të fakultetit, magjistraturës apo të doktoraturës të fituara në IAL-jashtë Kosovës.

2.3. Shtetasit e huaj, ose personat pa shtetësi mund të kërkojnë barasvlerën, respektivisht nostrifikimin e diplomave dhe dokumenteve tjera jashtë Kosovës, nëse për këtë kanë interes juridik në Kosovë.

2.4. Në rastin e paraqitjes për barasvlerësim të një diplome apo certificate të marrë nga një IAL-i jashtëm, IAL duhet të jetë i njohur nga Shoqata e Universiteteve Evropiane ose duhet të jetë i akredituar nga një agjenci e njohur kombëtarisht.

2.5. Barasvlerën e diplomave të IAL, respektivisht të certificateve të magistraturës dhe të doktoraturës të fituara jashtë Kosovës (diplomën e fituar, certificaten e magistraturës dhe të doktoraturës të fituara jashtë Kosovës (diplomën e fituar, certificaten e magistraturës dhe të doktoraturës) e bën këshilli profesional prej tre anëtarësh nga fakulteti përkatës në bashkëpunim me NARIC (National Academic Recognition Information Centre) dhe ENIC (European Network of Information Centre).

Neni 3

Kërkesa për barasvlerë, përkatësisht për nostrifikim

3.1. Kërkesës për barasvlerë, përkatësisht për nostrifikim të diplomës respektivisht certificate i bashkangjitet origjinali dhe fotokopja e origjinalit në tre ekzemplarë, me përkthim e cila duhet të jetë e vërtetuar nga ana e interpretit gjyqësor ose e noteruar nga ana e noterit.

3.2. Këshilli profesional, përkatësisht MASHT-i, me rastin e barasvlerës dhe nostrifikimit të diplomës respektivisht certificate, mund të kërkoj edhe dëshmi tjera në original ose në përkthim të verifikuar, prej të cilave mund të shihen, planprogramet, kohëzgjatja e studimeve në institucionet e huaja të arsimit të lartë, dhe elemente të tjera të cilat MASHT mund ti konsideroj të nevojshme.

3.3. Me rastin e barasvlerës dhe nostrifikimit të diplomës apo të certificate, të marrë jashtë Kosovës merret parasysh sistemi i shkollimit në vendin prej nga vjen kërkuesi, planprogrami mësimor, kushtet e pranimit në institucionin e huaj arsimor, kohëzgjatja e studimeve, të drejtat që jep diploma, respektivisht certificate në vendin ku është fituar, si dhe rrethanat e tjera të rëndësishme për barasvlerë dhe nostrifikim.

3.4. Nëse gjatë procedurës së barasvlerës dhe nostrifikimit konstatohet se, kushtet dhe rrethanat nga pika paraprake e këtij neni nuk përputhen me kushtet dhe rrethanat që ekzistojnë në institucionet e arsimit të lartë në Kosovë, barasvlerën dhe nostrifikimin e diplomës respektivisht të certificate duhet kushtëzuar vërtetimin paraprak të njohrive të kandidatit me anë të provimeve të caktuara plotësuuese, apo në ndonjë mënyrë tjetër, të cilën e cakton këshilli profesional i IAL të Kosovës në bashkëpunim me MASHT-in.

Neni 4

Afati për barasvlerë dhe nostrifikim

4.1. Institucioni i lartë arsimor, është i obliguar që Brenda dy muajve nga momenti i pranimit të kërkesës të përfundoj procedurën, dhe me shkrim ti dërgoj MASHT-it sugjerimin e vet për diplomën, certifikatën e marrë për nostrifikim.

4.2. Komisioni, i cili bën barasvlerënduhet të raportojë në MASHT:

a. Raporti duhet të ketë të gjitha të dhënat personale të kandi da tit:

Emëri, mbiemëri, drejtimi, fakulteti, titulli, thirrja shkencore, niveli sipas ISCED "Klasifikimi i Standardeve Ndërkombëtare Të Arsimit 1997 I miratuara nga Konferenca e përgjithshme e UNESCO -s.

b. Zgjedhjen e studimeve

c. Rekomandimin për nostrifikim apo mosnostrifikim

d. Numrin dhe lëndët shtesë, nëse diploma nuk e ka barasvlerën e njejtë me diplomat apo certifikatat përkatëse të lëshuara në IAL në Kosovë.

4.3. MASHT-i, në bazë të mendimit profesional të lëshuar nga ana e institucionit të lartë, Brenda 30 ditësh është i obliguar që të marrë aktvendim mbi barasvlerën, përkatësisht nostrifikimin e diplomës, respektivisht certifikates.

Neni 5

Përmbajtja dhe ruajtja e aktvendimit

5.1. Për nostrifikimin e dokumentit lëshohet aktvendimi i veçantë.

5.2. Origjinali i diplomës, përkatësisht certifikates, kopja e parë e përkthimit të vërtetuar dhe një kopje e aktvendimit, me të cilën diploma respektivisht certifikata nostrifikohet ose bëhet barasvlera, i dorëzohet personit i cili ka paraqitur kërkesë për nostrifikim respektivisht për barasvlerë, një ekzemplar mbetet në fakultetin përkatës, ndërsa ekzemplarët tjerë mbeten në MASHT.

5.3. MASHT-i, është i obliguar që të ruaj dokumentacionin dhe të mbaj evidence të posaqme lidhur me procedurën e nostrifikimit, përkatësisht barasvlerës së diplomave, certifikatave të jashtme.

5.4. Aktvendimin për barasvlerën e diplomës, respektivisht certificates, e nënshkruan kryetari I komisionit për barasvlerë pranë Universitetit apo fakultetit përkatës.

5.5. aktvendimin për nostrifikim e lëshon MASH t-i.

N en i6

Komisioni për barasvlerë, përkatësisht nostrifikim

6.1. komisioni duhet të formohet nga fakulteti përkatës.

6.2. Në rastet e veçanta, kur duhet të merren anëtarë nga fakultete të ndryshme, kom is bn in e fo m on U n i ve r s it e ti.

N en i7

Rregullorja e punës së komisionit

MASH T I, me rregullore të posaçme do të caktoj mënyrën e punës së komisionit, procedurën, si dhe kushtet tjera që duhet plotësuar gjatë procedurës së barasvlerës përkatësisht nostrifikimit të diplomave, respektivisht certifikatave të IAL, të jashtme.

N en i8

A nkesa

8.1. Pala e pakënaqur me aktvendimin mbi barasvlerën përkatësisht nostrifikimin e diplomës respektivisht certificates, ka të drejtë ti drejtohet MASHT it me ankesë në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së aktvendimit në këshillin për ankesa pranë MASHT -it.

N en i9

P agesa

9.1. Kandidati, I cili parashtron kërkesë për barasvlerë përkatësisht nostrifikim të diplomës apo të certificates, duhet që në emër të taksës administrative të paguaj shumën e caktuar të pa rave .

9.2. Lartësinë e shumës mbi procedurën e barasvlerës, përkatësisht nostrifikimit të diplomave, respektivisht certifikatave e cakton MASHT 4, me vendim të posaçëm.

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

Isuf Zeneli, Sekretar i Përhershëm